



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/148

Datë: 29/5/2022

Mbështetur në nenin 17 të Statutit të UP-së, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 12.5.2022, mori këtë:

V E N D I M

për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit me nr. prot. 456, datë 14.3.2022, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit me nr. prot. 4/74, datë 10.12.2021

1. Shfuqizohet pika 2 e Vendimit me nr. prot. 456, datë 14.3.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit me nr. prot. 4/74, datë 10.12.2021.
2. Lejohet rimbursimi i pagesave në emër të tarifave të shkollimit për vitin akademik 2021/2022 për kategorinë e studentëve si nën alinenë 4.4 të Vendimit me nr. prot. 456, datë 14.3.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit me nr. prot. 4/74, datë 10.12.2021.
4. Obligohen shërbimet financiare të njësive akademike që në bashkëpunim me shërbimet për studentë, ta bëjnë zbatimin e këtij vendimi mbështetur në kërkesat dhe dëshmitë e ofruara nga studentët.
5. Pikat tjera të Vendimit me nr. prot. 456, datë 14.3.2022, mbesin të pandryshuara.
6. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Vendimit me nr. prot. 456, datë 14.3.2022.
7. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit dhe do të zbatohet deri në një vendim tjetër.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UP-së, nga organet e përfaqësimit të studentëve në nivel qendror dhe në nivel njësish akademike, nga organizatat studentore dhe nga studentët individualisht ka pranuar disa kërkesa për rimbursimin e pagesave në emër të tarifave të shkollimit për vitin akademik 2021/2022, për studentët e nivelit Master të cilëve u është caktuar periudha e diplomimit prej 12 muajve, pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve. Mbështetur në nenin 116 të Statutit të UP-së dhe rekomandimet si në shkresën e MASHTI-t, me nr. prot. 01B/040, datë 9.3.2020, Këshilli Drejtues i UP-së ka marrë vendim t'i lirojë nga pagesa e tarifave të shkollimit studentët që i përkasin kësaj kategorie, por jo rimbursimin e pagesave për studentët që i kanë kryer obligimet para hyrjes në fuqi të vendimit në fjalë.

Duke marrë parasysh atë çfarë u tha më lart dhe me qëllim sigurimit të trajtimit të barabartë të kësaj kategorie të studentëve, Këshillit Drejtues i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim t'u dërgohet:

- Arkivit të UP-së,
- Menaxhmentit të UP-së,
- Sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
- Dekanëve të njësive akademike,
- Sekretarëve të njësive akademike,
- Shërbimit të financave në UP.



Këshilli Drejtues i UP-së

Dr. Arbëresha Nela - Turjaka, kryesuese